



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.344/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Ismet Zymeri, kandidat për anëtare në kuvend komunal të Komunës së Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave me postë, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 27.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.344/2025, e datës 24.10.2025, e parashtruar nga Ismet Zymeri, kandidat për anëtar të kuvendit komunal të Komunës së Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave me postë, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.344/2025, e parashtruar nga Ismet Zymeri, kandidat për anëtar në kuvend komunal të Komunës së Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon se pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të ardhura me postë, është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i votave — rreth 32 vota, nuk figurojnë në kutitë përkatëse. Këto vota janë dërguara nga familjarë të ngushtë, përkatësisht nga fëmijë të axhallarëve, shoqëri e afërt dhe anëtarë tjerë të regjistruara në listën zgjedhore.

Më tej në ankesë theksohet se pavarësisht se këto vota janë dërguar brenda afateve ligjore dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë numërimit të tyre është vërejtur mungesa e tyre e pashpjegueshme. Kjo gjendje ngre dyshime të bazuara se ka pasur mos regjistrim, humbje ose trajtim të pasaktë të këtyre fletëvotimeve, çka përbën shkelje të drejtpërdrejtë të ligjit dhe të parimeve themelore të procesit zgjedhor.

Parashtruesi i ankesës shton se në bazë të LZP-së, çdo qytetar me të drejtë vote duhet të ketë mundësinë që vota e tij të pranohet, të numërohet dhe të reflektohet në rezultatin përfundimtar. Mos regjistrimi ose zhdukja e rreth 32 votave bie ndesh me nenin 4 të Ligjit, i cili garanton barazinë e votës dhe respektimin e vullnetit të qytetarëve, standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme, të sanksionuara edhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kjo parregullsi, përveçse cenon të drejtën e qytetarëve për të votuar, dëmton drejtpërdrejt rezultatin zgjedhor, duke ndikuar direkt në mandatin tim dhe në përfaqësimin real të vullnetit të zgjedhësve.

Kërkon nga PZAP, që të urdhërojë verifikimin e plotë të procesit të pranimi, ruajtjes dhe numërimit të votave me postë për Komunën e Podujevës, me qëllim të identifikimit të shkaqeve të mos pasqyrimit të rreth 32 votave, të kërkojë sqarim zyrtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi trajtimin e këtyre fletëvotimeve dhe vendndodhjen e tyre aktuale, të ndërmerren masat e nevojshme ligjore për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor, duke përfshirë rihapjen dhe rivlerësimin e kutive përkatëse, nëse kjo është e nevojshme, të sigurohet që të gjitha votat e dërguara në mënyrë të rregullt të numërohen dhe të përfshihen në rezultatin përfundimtar, dhe që të aprovohet ankesa si e bazuar.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor sqaron se më datë 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve,

Bazaar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 1 Z Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR, ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 Për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike. Proces i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e familjareve të tij dhe rrethit të tij të ngushtë, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit, votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues.

Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja, pas përfundimit të numërimit të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta, fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga, KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet tij.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe votat me postë, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shqyrtimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidatit për anëtarët në Kuvendin e Komunës së Podujevës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet fakti me prova konkrete se ka pasur parregullsi në gjatë numërimit të votave. Sipas vlerësimit të panelit vetëm pretendimi nga ankesa se “pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të ardhura me postë, është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i votave — rreth 32 vota — nuk figurojnë në kutitë përkatëse. Këto vota janë dërguara nga familjarë të ngushtë, përkatësisht nga fëmijë të axhallarëve, shoqëri e afërt dhe anëtarë tjerë të regjistruara në listën zgjedhore”, e vlerëson si të pabazuar për faktin se parashtresuesi i ankesës nuk ka mbështetur pretendimet e tij me prova konkrete, rrjedhimisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në kuptim, paneli, në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetoj se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklarinimin e të familjarëve dhe shoqërisë në afërt, sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, është përcaktuar se “1.3. *liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.*” Prandaj për këtë arsye nuk i mori si ta bazuara, përkatësisht, nuk ia fali besimin deklarinimit se familjarët dhe shoqëria e afërt kanë votuar për të njëjtin, për të aprovuar ankesën si të bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal të Komunës së Podujevës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është e pabazuar pasi që nuk ka bashkëngjitur asnjë provë që dëshmojnë parregullsi gjatë numërimit të votave me postë dhe mungesave të votave tek kandidati, mbetet vetëm në suaza të dyshimit të arsyeshëm, por jo të dyshimit të bazuar se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZLAnr.344/2025 datë 27.10.2025

Kryesuese e panelit
Hidajete Gashi Alaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

